4.1	Ndërtimi i pusëve degëzuese sipas planeve egzekutive, Dimensionel dhe gjeometria e pusëve të përshatlet me montimin e pjesëve fazonike. Në çmim të llogaritët edhe kapaku nga materiali "KOMPOZIT", sipas standardeve ISO-9001 dhe ISO 14001 më aftësi mbajtëse 40t. Gjithëashu të llogaritët edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	copë	7.00	116.95	818.65
4.2	Ndërtimi i pusëve degëzuese, dhe mbyllës fundorë për pusetat e hidrantëve sipas planeve egzekutive. Dimensionel dhe gjeometria e pusëve të përshatlet me montimin e pjesëve fazonike. Në çmim të llogaritët edhe kapaku nga materiali "KOMPOZIT", sipas standardeve ISO-9001 dhe ISO 14001 më aftësi mbajtëse 40t. Gjithëashu të llogaritët edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	copë	2.00	495.76	991.52
4.3	Furnizimi dhe vendosja në vepër e betonit për ankerimin horizontal dhe vertikal të gypave sipas detaleve në projekt.	m ²	5.00	67.80	339.00
4.4	Furnizimi dhe vendosja në vepër e blloqeve të betonit për stabilizimin e pjesëve fazonike në puseta	m ²	3.00	67.80	203.40
4.5	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastimi i tyre në beton me lyrje antikorozeve.	copë	35.00	1.69	59.15
				0.31	70.00
					Subtotali 4: 2,846.00
5	PUNËT INSTALUESE DHE MONTUESE				
	Furnizimi, transporti dhe instalimi i tubave PE 100. , Montimi bëhet me saldimit ballorë dhe sipas nevojës me elektro-saldim. Verejllje: Puntori i cili do të bëjë saldimit e gypave duhet jetë i çertifikuar sipas EN 13067 : 2013				
5.1	PE 100, Ø110/PN 10 bar.	m'	760.00	6.19	4704.40
5.2	Furnizimi transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues me fiye metalike 20 cm mbi tubin e ujësjellësit .	m'	760.00	0.34	258.40
5.3	Furnizimi transporti dhe vendosja e shiritit detektues mbi tubin e ujësjellësit .	m'	760.00	0.21	159.60
				0.04	190.00
					Subtotali 5: 6,042.00
6	PUNËT MONTUESE				
	Furnizimi,transporti dhe instalimi i pjesëve fazonike nga materiali i gizes dhe polietileni nëpër nyje sipas planit të nyjeve dhe skicave instaluese . montuese dhe detaleve të pusëve,të gjitha duhet jenë PN10 bar.				
6.1	E.Muff Ø 75mm	copë	2.00	12.71	25.42
6.2	E.Muff Ø 110 mm	copë	18.00	16.95	305.10
6.3	E.Muff Ø 160 mm	copë	1.00	27.97	27.97
				5.03	33.00

6.4	AF Ø 75mm	copë	2.00	15.25	2.75	18.00	36.00
6.5	AF Ø 110mm	copë	18.00	21.19	3.81	25.00	450.00
6.6	AF Ø 160mm	copë	1.00	33.90	6.10	40.00	40.00
6.7	I DN 100/00 mm	copë	6.00	72.03	12.97	85.00	510.00
6.8	I DN 150/100mm	copë	1.00	88.98	16.02	105.00	105.00
6.9	Valvolë shiber DN 65 mm	copë	2.00	75.42	13.58	89.00	178.00
6.10	Valvolë shiber DN 100 mm	copë	18.00	118.64	21.36	140.00	2,520.00
6.11	FF DN 150/800mm	copë	2.00	76.27	13.73	90.00	180.00
6.12	FF DN 65/800mm	copë	2.00	38.14	6.86	45.00	90.00
6.13	FF DN 100/800mm	copë	18.00	66.10	11.90	78.00	1,404.00
6.14	FFR DN 150/100mm	copë	2.00	57.63	10.37	68.00	136.00
6.15	Montues demontues DN 65 mm	copë	2.00	63.56	11.44	75.00	150.00
6.16	Montues demontues DN 100 mm	copë	11.00	101.69	18.31	120.00	1,320.00
6.17	Montues demontues DN 150 mm	copë	1.00	131.36	23.64	155.00	155.00
Subtotali 6:							7,697.00
7 PUNËT TJERA							
7.1	Largimi i ujërave me pompë gjatë kohës së punimeve.	orë	15.00	4.24	0.76	5.00	75.00
7.2	Punimi i hidroizolimit të pllakës së poshtme, mureve dhe pllakës së epërme (kondor 4 mm dhe bitullit).	m ²	100.00	6.78	1.22	8.00	800.00
7.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i foljës për mbrojtjen e hidroizolimit .	m ²	100.00	1.19	0.21	1.40	140.00
7.4	Testimi i tubit PE 100 sipas përshkrimit në përpulshmëri me kushtet teknike.	m'	760.00	0.34	0.06	0.40	304.00
7.5	Dezinftimi i tubit PE 100 sipas përshkrimit në përpulshmëri me kushtet teknike.	m'	760.00	0.34	0.06	0.40	304.00
Subtotali 7:							1,623.00
8 PUNËT PËRFUNDIMTARE							
8.1	Pasirimi i terrenit nga mbeturinat dhe transporti i tyre deri në deponinë legale, maks. 5 km	Paushall	1.00	101.69	18.31	120.00	120.00
8.2	Hartimi i projektit të ekzekutuar mbas përfundimit të ekzekutimit të punimeve në terren (pas çdo profili të ekzekutuar), që nënkupton matjet gjeodezike dhe përpilimi i dokumentacionit teknik të punëve për punët e zbatuara si dhe dorëzimi i investitorit në tri kopje.	m'	760.00	0.42	0.08	0.50	380.00
Subtotali 8:							500.00
REKAPITULLIMI							
1	PUNËT PËRGADITORE						440.00 €
2	PUNËT DEMOLUESE						600.00 €
3	PUNËT E DHEUT						9,070.00 €
4	PUNËT E BETONIT DHE ARMATURËS						2,846.00 €
5	PUNËT INSTALUESE DHE MONTUESE						6,042.00 €
6	PUNËT MONTUESE						7,697.00 €
7	PUNËT TJERA						1,623.00 €
8	PUNËT PËRFUNDIMTARE						500.00 €
Totali:							28,818.00 €

PUNËT E NDRIQIMIT DHE INFRASTRUKTURËS NËNTOKESORE TË RRUGËS LAHË NIMANI - MITROVICË							
Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi - €			Shuma - €
1	Minja e dheut për Puselë me dimensione si në pjesën grafike	m ²	352.00	1.27	0.23	1.50	528.00
2	Minja e dheut për gypa të instalimeve elektrike nëntokësore me dimensione 1.8 x 0.8m në të cilën do të vendosen kater gypa Ø200 SN4 dhe dy gypa Ø110 SN4 për instalim të kabllëve.	m ²	1,220.00	1.27	0.23	1.50	1,830.00
3	Minja e dheut për gyp të ndriqimit me dimensione 0.8 x 0.5m, shtrirja e gypave PVC, reres, ngjeshja dhe mbulimi i kanalit pas shtrirjes së gypave.	m ²	180.00	1.27	0.23	1.50	270.00
4	Furnizimi dhe shtrimi i rërës në trashësi (10 + 10) cm rreth lubave të kabllëve	m ²	200.00	3.39	0.61	4.00	800.00
5	Mbushja e kanalit me dhe në shiresa, duke e ngjeshur në çdo 20 cm.	m ²	1,200.00	0.42	0.08	0.50	600.00
6	Ngarkimi i dheut të tepert dhe transporti në deponinë të cilën e cakton mbikqyrësi në bashkëpunim me zyrtarët komunal.	m ²	550.00	0.42	0.08	0.50	275.00
7	Furnizimi transporti si dhe vendosja me betonarme e puselave energjetike për nivel tensioni 1kV me dimensione të mbrendshme 2.0 x 2.0 x 2.0 m, trashësia e mureve 15cm dhe i lypër me material hidroizolues. Puselat duhet të punohen nga betoni C-25/30 dhe armatura rrejt 2xQ503 . Në çmim të kalkulohet komplet pusela e përfunduar dhe kapaku katror 0.65/0.65 m ² , nga materiali kompozit, për ngarkesa T =40 ton si dhe shkallët nga materiali galvanizuar kundra ndryshkjes çdo 30cm si në pjesën grafike	cope	16.00	508.47	91.53	600.00	9,600.00

8	Furnizimi transporti si dhe vendosja me betonarme e puselave kablloviqe te tensionit te ulet me dimensione te mbrendshme 1.2 x 1.2 x 1.2 m. Irashesia e mureve 15cm dhe i lyster me material hidroizolues. Puselat duhet te punohen nga betoni C-25/30 dhe armatura rrejt 2xQ503 . Ne qmim te kalkulohet komplet puseta e perfunduar dhe kapaku kalror 0.65/0.65 m' , nga materiali kompozit, per ngarkesa T=40 ton si ne pjesen grafike.	cope	16.00	423.73	76.27	500.00	8.000.00
9	Furnizimi dhe montimi i gypave te brinjezuar PE Ø200mm, ne kanalim ku do te vendosen kabllo te varesi te nevojës. Fillimisht gypat kalojne nËpËr puseta pa u ndËrprerË ndËrsa pËrfundojnË nË pusetat e vendosura nË skajet nË fillim dhe nË fund tË rrugËs.	m	3,600.00	3.39	0.61	4.00	14,400.00
10	Furnizimi dhe montimi i gypave te brinjezuar PE Ø110mm, ne kanalim ku do te vendosen kabllo te varesi te nevojës. Fillimisht gypat kalojne nËpËr puseta pa u ndËrprerË ndËrsa pËrfundojnË nË pusetat e vendosura nË skajet nË fillim dhe nË fund tË rrugËs.	m	1,800.00	2.12	0.38	2.50	4,500.00
11	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike tË hekur karbonik te ndriqimit, me lartesi 10 m, te galvanizuar me zink te nxehte, me forme konike me dore per hapje, forme dhe lrashesi te mureve 4mm dhe pamje te dhene si ne pjesen grafike. Shtyllat jane per montim me mbjelje, me te gjitha pjeset si kapaket e shtylles, terminallet lidhese. Shtylla dhe kapaku duhet te jene te galvanizuara me zink te nxehte sipas ISO 1461 dhe ISO 898 sipas paragrafit 5.8&6.8 dhe 8.8. Shpejtësia dizajnuese e eres duhet te jete 130km/h.	copë	19.00	254.24	45.76	300.00	5,700.00
12	Furnizimi dhe montimi i krahut te dylishte te shtylles se ndriqimit me gjatesi 1.2m dhe forme e dimensione sikur ne detajet e vizatimit, i galvanizuar ne zink te nxehte, me forme te dhene si ne pjesen grafike	copë	18.00	55.08	9.92	65.00	1,170.00
13	Furnizimi dhe montimi i krahut te katerfishte te shtylles se ndriqimit me gjatesi 1.2m dhe forme e dimensione sikur ne detajet e vizatimit, i galvanizuar ne zink te nxehte, me forme te dhene si ne pjesen grafike	copë	1.00	72.03	12.97	85.00	85.00
14	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriquese te tipit LED 100W, me forme te dhene ne pjesen grafike dhe me karakteristika si vijon: • Sistem modular (nga 20 nË 120 LED) • Alumin i derdhur • Klasa e izolimit 1 • Shkalla e mbrojtjes IP66 • Modulet LED tË krijuara nË pËrputhje me rregullat biologjike • Optika dispozicion: AC, ACB, PR, OSHP, TS, TSB, TM, TMB, QV, QVS, IS • Temperaturat e ngjyres e 4.000 K • Lumen: min 13000 • Lumen per wat: 130lm/W • Jetegjatesia: min 50000ore pune	copë	40.00	72.03	12.97	85.00	3,400.00
15	Furnizimi dhe montimi bazes se aradililit per lidhje dhe vazhdim te kabllos furnizuese te ndriqimit NYM 3x1.5 mm2, per shtylle	copë	19.00	29.66	5.34	35.00	665.00
16	Furnizimi dhe montimi i kabllos per furnizim te poqit ndriqes nga boza e aradililit NYY-J 3X1.5 mm2.	m	400.00	2.12	0.38	2.50	1,000.00
17	Porosia dhe vendosja e kabllos furnizuese tË tipit NYY-J(AL) 4x25mm²	m	450.00	3.81	0.69	4.50	2,025.00
18	Furnizimi dhe vendosja e shiritit per lokezim Fe/Zn 25x4 mm	m	450.00	1.69	0.31	2.00	900.00
19	Furnizimi dhe montimi i lidheseve kryqezore per shirit	cope	25.00	2.54	0.46	3.00	75.00
20	Mihja e dheut per bazament te shtyllave me dimensione 80x80x100 cm	cope	19.00	1.69	0.31	2.00	38.00
21	Belonimi i bazamentit tË shtyllave 70x70x80 cm me beton tË tipit M830 me ankerim	cope	19.00	55.08	9.92	65.00	1,235.00
22	Porosia dhe vendosja e gypit te brinjezuar PVC Ø63 pËr kabllo furnizuese te trupave ndriqes	m	450.00	1.27	0.23	1.50	675.00
23	Porosia dhe vendosja e gypit metalik me diameter DN100mm per kalim te rrugeve	m	30.00	4.24	0.76	5.00	150.00
24	Vendosja e shiritit identifikues	m	450.00	0.42	0.08	0.50	225.00
25	Furnizimi dhe montimi i siguresave shkrimes 63A tip lelle se bashku me bazamente per kyqjen e kabllos furnizuese ne trafoblinde	copë	1.00	12.71	2.29	15.00	15.00
26	Furnizimi transporti dhe montimi i kuadrit qendror KQ 1, tip A/FK6-SHS me bazament, nga poliesteri, me dimensione 108x112x32.2 cm, komplet me elemente lidhese dhe shtrenguese siq eshte treguar ne skemen njeopolare	copë	1.00	474.58	85.42	560.00	560.00
27	Furnizimi dhe montimi i njehsorit elektrik te tipit 3x400/230V, 100A, 50Hz	copë	1.00	67.80	12.20	80.00	80.00
28	Siguresa trepolare magnetotermike AS 63A	cope	1.00	8.47	1.53	10.00	10.00
29	Siguresa njeopolare 6A	copë	1.00	8.47	1.53	10.00	10.00
30	Siguresa trepolare 32A	copë	3.00	8.47	1.53	10.00	30.00
31	Nderpreres zgjedhes 63A 1-0-2	copë	1.00	8.47	1.53	10.00	10.00
32	PËrçues PF 1x10mm²	m	50.00	6.78	1.22	8.00	400.00
33	PËrçues PF 1x2.5mm²	m	50.00	5.08	0.92	6.00	300.00
34	Porosia dhe montimi i kontaktoreve tË fuqise CS 63A	copë	1.00	8.47	1.53	10.00	10.00
35	Porosia dhe montimi i relese Astrale	copë	1.00	8.47	1.53	10.00	10.00
36	Mikronderpreres 6A	cope	2.00	4.24	0.76	5.00	10.00
37	Trup ndriqes per orman LED me nderpreres	copë	1.00	4.24	0.76	5.00	5.00
38	PrizË OG 16A	copë	3.00	8.47	1.53	10.00	30.00
39	NdËrprerËs tË tipit GS-16-66U	copë	6.00	8.47	1.53	10.00	60.00
40	Atestet e Impedances se Qarkut	copë	3.00	211.86	38.14	250.00	750.00

41	Alestet e llokzimit dhe te izolimit te kabllove	copë	3.00	211.86	38.14	250.00	750.00
42	Porosia dhe montimi i papuqeve gypore 25, 16 dhe 10mm	copë	170.00	1.69	0.31	2.00	340.00
43	Pune te paparapara në paramasë	paushall	1.00	296.61	53.39	350.00	350.00
						Subtotali:	61,876.00 €

SINJALIZIMI VERTIKAL DHE HORIZONTAL PËR RRUGËN LAHË NIMANI - MITROVICË

1. SINJALIZIMI VERTIKAL

Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia			Çmimi njësi - €	Shuma - €
1.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjës në formë trekëndësi, Dimenzionet: 90x90 cm	copë	1.00	67.80	12.20	80.00	80.00
1.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjës në formë katërkëndëshi, Dimenzionet: 60x60 cm	copë	10.00	50.85	9.15	60.00	600.00
1.3	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjës së trafikut në formë rrethi: Dimenzionet: li-60 cm	copë	2.00	50.85	9.15	60.00	120.00
1.4	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjës udhëzues vertikale: Dimenzionet 30x100	copë	1.00	84.75	15.25	100.00	100.00
1.5	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjës rreshtim mjeteshe, Dimenzionet: 90x90 cm	copë	15.00	67.80	12.20	80.00	1,200.00
1.6	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) semaforëli e këmbësorëve dhe biciklistët	copë	8.00	423.73	76.27	500.00	4,000.00
1.7	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) semaforëli në formë të shkronjës (I)	copë	2.00	423.73	76.27	500.00	1,000.00
1.8	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) semaforëli mbiportal	copë	4.00	423.73	76.27	500.00	2,000.00
<p>Verejtje: Shenjat duhet te punohen nga pllaka te aluminit me trashesi 2mm ne te cilen ngjitet folja retroreflektuese e kualitetit DG (Diamond Grade e klasit -II-) me unazen rrethore te llopit alforme prej alumini. Shyllat mbajtese te shenjave prej çeliku te zinkuar te jene Ø60mm me trashesi te mureve 2 mm.</p>							
						Subtotali 1:	9,100.00 €

2. SINJALIZIMI HORIZONTAL

Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia			Çmimi njësi - €	Shuma - €
2.1	Furnizimi dhe shenjezimi i rruges me ngjyrë te bardha.	m ²	370.70	2.54	0.46	3.00	1,112.10
2.2	Furnizimi dhe shenjezimi i shlegut për biciklist, staza duhet te jete e ngjyrosur dhe e shenjezuar me ngjyre te kuqe dhe te baraqe. Karakteristikat e ngjyrave duhen te jene: Density colour shades: 1.56 ± 0.04 kg/dm ³ , Viscosity: 33-55 s DIN 53211 - 6(20°C), Solid content: Min 75.0 w%. Për karakteristikat e ketyre ngjyrave nevojitet Certifikata nr.: 208/C5/2017/9.1. Materialet per shiresen e ngjyres te jene te testuara nga Institutit IAAF dhe te dokumentuara me certifikat nga ky Institut O.E. Duhet te deshmoj certifikat ose te kele autorizim nga nje kompani e konzorciumit per qerifikaten ne fjale.	m ²	1,378.00	8.05	1.45	9.50	13,091.00
<p>Verejtje: Produkti i materialit te perdorur duhet te jete mase plastike dy komponenteshe e ftohet (prej dy materialeve ne gjendje te lenget apo komponenteve pluhur pa trefës dhe të cilët kur përzihen ngurtesohen) me grimaca te qelqit dhe reres.</p>							
						Subtotali 2:	14,203.10 €
1	SINJALIZIMI VERTIKAL						9,100.00
2	SINJALIZIMI HORIZONTAL						14,203.10
						Totali:	23,303.10 €

Rekapitullimi I Përgjithshëm

1	Punët e Rrugëve		577,503.30 €
2	Punët e Kanalizimit Fekal		105,410.00 €
3	Punët e Kanalizimit Atmosferik		95,543.00 €
4	Punët e Ujësjellësit		28,818.00 €
5	Punët e Ndrizimit Publik		61,876.00 €
6	Punët e Sinjalizimit		23,303.10 €
		Totali:	892,453.40 €



Dega PRISHTINË

Numri i polices 060010260087191

1 Të dhënat për agjentin - Agent details

Emri dhe mblemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Fatmir Hajdini	Rr."Eqrem Qabej " Llam.1	038545011	001026

2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë

I SIGURUARI	KOSOVA ASFALT SH P K		
Adresa	GAQK Ferizaj		
Përfaqësuar nga Z.	VALDRIN SHABANI	Nr. i biznesit	811052646

3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji:	SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT
Ndertimi i rrugës Lah NIMANI në Mitrovicë. Nr. i prokurimit : 642-22-6315-5-1-1 Nr. i brendshëm : 642/22/066/511	

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër) b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfituesi	Komuna e Mitrovicës
Adresa	Rr. "Bedri Gjinaj"
Shuma e siguruar €	89,245.34 €

4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merr përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Policë.
- Efekti veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thotë fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfituesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thotë se Përfituesi nuk mund të paraqes kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit për përmbyshjen e detyrimeve të tij ndaj Përfituesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfituesi e ka të drejten t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi tek Siguruesi / Garantuesi)

Periudha e sigurimit/garancisë Fillon me: 23.11.2022 Mbaron me: 22.11.2024

5

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
89,245.34 €	3,215.00 €	578.70 €	3,793.70 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht 3,793.70 € Data 23.11.2022 Me këste: Numri i kësteve In Instalments:Nr. of Inst.

Shënime tjera:

I Siguruar / The Insured VALDRIN SHABANI Data e lëshimit / Issued date dega: Prishtinë Siguruesi / The Insurer Fatmir Hajdini



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Mitrovicës**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **KOSOVA ASFALT SH P K , GAQK Ferizaj**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Ndertimi i rrugës Lah NIMANI në Mitrovicë.

Nr. i prokurimit : 642-22-6315-5-1-1

Nr. i brendshem : 642/22/066/511

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Tetëdhjete e Nënt mijë e Dy qinde e Katerdhjete e Pes e Tridhjete e Kater 89,245.34 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **89,245.34 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **730 ditë** prej **23.11.2022** deri më **22.11.2024**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.


Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose Institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.

Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralla
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
23.11.2022

PJESA II E KONTRATES -KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguresve të Kontraktuesit për të kërkuar

pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që

inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritë nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

